

# BARAZIA GJINORE

Metadate Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure

(ESMS)

INSTAT

## Metadate Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	5
11. Menaxhimi i cilësisë .....	6
12. Rëndësia.....	6
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	7
15. Kohëzotueshmëria dhe krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	8
17. Rishikimi i të dhënave.....	8
18. Përpunimi statistikor .....	9
19. Komente.....	11
Aneks .....	11

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Zhvillimit të Statistikave Sociale, Drejtoria e Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Isida Gorce
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Statistikave Sociale
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	<a href="mailto:igorces@instat.gov.al">igorces@instat.gov.al</a>
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	09.07.2021
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	09.07.2021
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	09.07.2021
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Qëllimi kryesor i Statistikave të Barazisë Gjinore është të ofrojë informacion për fusha të ndryshme të jetës të tilla si popullsia, shëndetësia, arsimi, tregu i punës, përfshirja sociale, dhe vendimmarrja, të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së barazisë gjinore. Në përmbushje të këtij qëllimi, INSTAT publikon çdo vit edhe publikimin “Burrat dhe Gratë në Shqipëri”. Njohja e situatës së grave dhe burrave në shoqëri, në të gjitha sferat e jetës orienton politikbërësit drejt vendimarrjeve të duhura mbi këto politika. Matës të barazisë dhe pabarazisë gjinore janë dhe 2 indekse që INSTAT llogaritet. Indeksi i Pabarazisë Gjinore i cili tregon tregon humbjen potenciale në zhvillim njerëzor, si rezultat i pabarazive ndërmjet arritjeve të burrave dhe grave në dimensionet e shëndetit riprodhues, fuqizimit politik, arsimor dhe tregut të punës. Ky indeks matet çdo vit nga INSTAT. Ndërkohë Indeksi i Barazisë Gjinore është llogaritur për herë të parë në 2020. Ai mat barazinë gjinore në gjashtë fusha thelbësore: puna, paraja, dijet, koha, pushteti, shëndeti dhe në dy fusha të tjera: ndërthurjen e pabarazive dhe dhunës, bazuar në kuadrot konceptuale specifike.</p>

3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Statistikat gjinore reflektojnë ndryshimet ose pabarazitë e situatës së burrave dhe grave në të gjithë fushat e jetës. Statistikat e disageguara sipas gjinisë tregojnë gjendjen e burrave dhe grave në fusha të tilla si popullsia, arsimi, tregu i punës, përfshirja sociale, shëndetësia dhe vendimmarrja. INSTAT, plotëson dhe setin Minimal të Treguesve Gjinorë, i cili përfshin 52 tregues të përcaktuar nga Komisioni Statistikor në bashkëpunim me UN Women për matjen e treguesve gjinore, nga të cilët 22 janë tregues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Statistikat gjinore mbulojnë gjithë territorin e Shqipërisë dhe përfshijnë statistika në fusha si popullsia, shëndetësia, arsimi, tregu punës, sistemi i drejtësisë, gratë në vendimmarrje si dhe të drejtat e njeriut.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p><b>Barazia gjinore</b> përshkruan konceptin sipas të cilit të gjitha qëniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e personalitetit të tyre dhe të bëjnë zgjedhje pa kufizime të vendosura nga stereotipat, rolet e ngurta gjinore apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë se sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave konsiderohen, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Ajo nuk do të thotë se gratë dhe burrat duhet të bëhen njëjloj, por se të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse janë lindur femra apo meshkuj.</p> <p><b>Indeksi i Pabarazisë Gjinore IPB</b> tregon humbjen potenciale në zhvillim njerëzor, si rezultat i pabarazive ndërmjet arritjeve të burrave dhe grave në dimensionet e shëndetit riprodhues, fuqizimit politik, arsimor dhe tregut të punës. GII varion nga 0 në 1. Vlera më të larta të GII tregojnë më shumë pabarazi dhe më shumë humbje në zhvillimin njerëzor si pasojë e pabarazisë.</p> <p><b>Indeksi i Barazisë Gjinore</b> mat barazinë gjinore në gjashtë fusha thelbësore: puna, paraja, dijet, koha, pushteti, shëndeti dhe në dy fusha të tjera: ndërthurjen e pabarazive dhe dhunës, bazuar në kuadrot konceptuale specifike.</p> <p>Përkufizime të tjera lidhur me tregues specifik sipas tematikës që mbulon gjenden dhe në publikimin “Burra dhe Gra”, si pjesë më vete.</p>
3.5. Njësia statistikore	<p>Njësia statistikore është individi: burrë, grua.</p>
3.6. Popullata statistikore	<p>Popullata në statistikat gjinore përfshin burrat dhe gratë sipas karakteristikave të ndryshme ose sferave të ndryshme të jetës së tyre, në seri kohore 3 ose 5 vjet. Viti fundit përfshin të dhënat e 2020.</p>
3.7. Zona e referencës	<p>Statistikat gjinore mbulojnë të gjithë territorin e vendit.</p>
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Për herë të parë, statistikat gjinore janë përfshirë në publikimin e dedikuar “Burra dhe Gra në vitin 2008, ku dhe ligji i Barazisë Gjinore e ktheu të detyrueshëm mbledhjen e të dhënave gjinore. Më pas, pati një shkaputje deri në 2013, dhe më pas u publikuan çdo vit. Seritë kohore të treguesve ishin 5 ose 3 vite në varësi të treguesve.</p>
3.9. Periudha bazë	<p>Nuk aplikohet.</p>

<b>4. Njësia matëse</b>	Njësia bazë statistikore në statistikat gjinore janë Invididët: burrat, gratë.
<b>5. Periudha e referencës</b>	Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Ky raport i përket vitit referencë 2020.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>Baza ligjore mbi të cilën u mbështetet Barazia Gjinore përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Ligji Nr.17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”</a></li> <li>• <a href="#">Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2017-2021</a></li> <li>• <a href="#">Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”</a></li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat gjinore shërbejnë si bazë për përdorues të ndryshëm. Duke qenë se bazohen në burime administrative ose anketa nga fusha të ndryshme, INSTAT nuk transmeton të dhëna në EUROSTAT për barazinë gjinore.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	<p>Të dhënat e mbledhura nga njësitet statistikore konsiderohen si rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare", si dhe <a href="#">Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale"</a>.</p> <p>Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmer të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;</p> <p>Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT.</p>

	Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësish statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	<a href="#">Kalendari i Publikimeve</a> është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligji Nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare, statistikant zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit vjetor Burra dhe Gra janë si më poshtë:  <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Website – online release – tema Barazia Gjinore</li> <li>2. Kërkesat e shkruara (me postë ose <a href="#">email</a>);</li> <li>3. Seksioni <a href="#">kërkesa të dhënash</a>, për përdoruesit e jashtëm.</li> </ol>
<b>9. Shpeshësia e shpërndarjes</b>	Statistikat gjinore dhe indekset gjinore publikohen në baza vjetore.
<b>10. Akses i të dhënave dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Sipas kalendarit të publikimeve, të dhënat gjinore në Shqipëri, shpërndahen çdo vit me një publikim më vete “Burrat dhe Gratë në Shqipëri”. Publikimi mundësohet në faqen zyrtare të INSTAT, në bazën e të dhënave statistikore Px-web, gjithashtu shpërndahen elektronikisht tek përdoruesit.
10.2. Publikime	Përdoruesit mund t’i gjejnë publikimet mbi Barazinë Gjinore në faqen zyrtare të INSTAT sipas rregulloreve dhe ligjit referues të organizuara si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Burra dhe Gra në Shqipëri</a></li> <li>• <a href="#">Njoftim për media - Burrat dhe Gratë në Shqipëri</a></li> <li>• <a href="#">Publikimi interaktiv Burra dhe Gra</a></li> <li>• <a href="#">Indeksi i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë 2020</a></li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi statistikant gjinore publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin <a href="#">Databaza Statistikore</a> .
10.4. Akses i të dhënave mikro	Të dhënat nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare".

10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për <a href="#">Kërkesë të dhënash formulari</a> .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacion shtesë mbështetës u ofrohet çdo përdoruesi në fund të publikimit. Në faqen e INSTAT, ndodhet një seksion lidhur me <a href="#">Metodologjinë</a> e përdorur për temën “Barazia Gjinore.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori Zhvillimit të Statistikave Sociale dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat e Statistikave të Barazisë Gjinore për qëllime të brendshme.
<b>11. Manaxhimi i cilësisë</b>	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr. 17/2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranura ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimet i të dhënave për Statistikat e Barazisë Gjinore janë anketat sociale dhe burimet administrative. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.
<b>12. Rëndësia</b>	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e statistikave të barazisë gjinore klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdoruesit e jashtëm janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Institucionet e Administratës Publike;</li> <li>○ Universitetet;</li> <li>○ Bizneset;</li> <li>○ Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit;</li> <li>○ Organizata kombëtare jofitimprurëse;</li> </ul> </li> <li>• Përdoruesit e brendshëm janë sektorët brenda INSTAT të cilët përdorin statistikën si input për punën e tyre.</li> </ul> <p>Statistikat gjinore reflektojnë ndryshimet ose pabarazitë e situatës së burrave dhe grave në të gjithë fushat e jetës. Njohja e situatës së grave dhe burrave në shoqëri, në të gjitha sferat e jetës orienton politikbërësit drejt vendimarrjeve të duhura mbi këto politika.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me temën Barazia Gjinore për vitin 2020 janë rreth 7,462 klikime.</p> <p>Gjatë 2020, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve</p>

	<p>nga publikimet e INSTAT. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e Barazisë Gjinore është vlerësuar me 3.71 (74.2%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit <a href="#">Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve</a>.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të Barazisë Gjinore gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në Programin e Statistikave zyrtare (2017-2021). Shkalla e plotshmërisë së të dhënave mbi Barazinë Gjinore në Shqipëri për 2020, është 100%.</p>
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Përlllogaritja e statistikave gjinore përfshin kombinimin e informacionit nga një sërë burimesh të dhënash administrative të cilat konsiderohen të jenë shumë të besueshme, por gjithashtu përfshin të dhëna nga anketa të ndryshme sociale, të cilat janë subjekt i problemeve të mbulimit dhe gabimeve të lidhura me këto burime të dhënash. Në këto raste, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës.</p> <p>Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur normat e përgjigjes, ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacioni është mbledhur me intervistim ballë për ballë nga anketuesit në bazë të udhëzimeve të përgatitura për këtë qëllim.</li> <li>• Staf i anketues është i trajnuar se si të sillen në mënyrë etike me rastet e personave të cilët refuzojnë të përgjigjen.</li> </ul>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Gabimet në burim mund të sjellin dhe pasaktësi në statistikat gjinore. Problemet që mund të ketë me mbulimin dhe me azhornimin e kampionit këto anketa mbarten edhe në përlllogaritjet tona.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabim të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jokampionimit trajtohen bazuar në Politika e Trajtimit të Gabimeve.</p> <p>Në rastin e anketave, gabimet e jo kampionimit përfshijnë:</p> <p>Mos-përgjigjet, në nivel rekordi merr në konsideratë individët që nuk janë në gjendje apo të gatshëm për të dhënë përgjigje apo kur ekzistojnë pengesa të tjera për të përfunduar intervistën.</p> <p>Mbi-mbulimin, që ndodh kur individi i zgjedhur është në një pozicion të caktuar objekt i anketimit dhe gjatë procesit të intervistimit ai nuk është më objekt i anketimit.</p>
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>	
14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet mbi statistikat e “Barazisë Gjinore” janë publikuar në faqen zyrtare të INSTAT 190 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 190 ditë). Periudha referuese e rezultateve të Barazisë Gjinore është 31 Dhjetor 2020.</p>



	<table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>7/9/2021</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>190</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	7/9/2021	Afatet kohore	190		
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e publikimit	7/9/2021								
Afatet kohore	190								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat mbi “Barazia Gjinore”, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave mbi “Barazinë Gjinore” për vitin 2020 është shtyrë me 9 ditë për shkak të situatës së krijuar nga Covid -19.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>6/30/2021</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>7/9/2021</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>9</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	6/30/2021	Data e publikimit	7/9/2021	Vonesa në kohë	9
Periudha referuese	12/31/2020								
Data e shpallur	6/30/2021								
Data e publikimit	7/9/2021								
Vonesa në kohë	9								
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>									
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Barazinë Gjinore janë gjithëpërfshirëse; ato prodhohen në nivel kombëtar. Gjithashtu ka tregues të cilat prodhohen dhe publikohen në nivel qarku.								
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat mbi Barazinë Gjinore dhe llogaritja e indeksit të pabarazisë gjinore datojnë që nga viti 2013 referuar databazës statistikore. Në vitin e fundit, pra tek të dhënat të cilat i referohen 2020 janë shtuar edhe treguesit sipas gjinisë nga anketat sociale në familje edhe treguesit mbi të drejtat e njeriut.</p> <p>Për treguesit bazë, të dhënat mbi Barazinë Gjinore janë të krahasueshme ndër vite duke filluar nga 2016, duke siguruar një krahasueshmeri kohore prej 5 vitesh (<math>CC2=Jlast-Jfirst+1=5</math>).</p>								
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.								
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave është kontrolluar para se të finalizohet. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca në seri e tyre.								
<b>16.Kostoja dhe ngarkesa</b>	<p>Personat që punojnë për statistikën e barazisë gjinore janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi i përgjithshëm në zyrat qendrore: 1 punonjës</li> </ul>								
<b>17. Rishikimi i të dhënave</b>									
17.1. Politika e rishikimit	<p>Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <a href="#">Politika e revizionimit</a></li> <li>• <a href="#">Politika e trajtimit të gabimeve</a></li> </ul>								
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast se burimet administrative raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara për treguesit e shqyrtuar për vlerësimin e barazisë gjinore, ky informacion përditësohet nga INSTAT. Gjithashtu në rastin e anketimeve të dhënat për statistikën e barazisë gjinore rishikohen në rastet kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ka ndryshime metodologjike</li> <li>• Rishikohen peshat (burime të reja dhe / ose burimeve të përmirësuara, korrigjime të gabimeve)</li> </ul>								



Të gjitha rishikimet janë bërë transparente për përdoruesit dhe janë pjesë e çdo botimi.

## 18. Përpunimi statistikor

Burimet kryesore të të dhënave mbi të cilën bazohen përlllogaritjet vjetore të barazisë gjinore janë:

- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** për lindjet dhe vdekjet sipas gjinisë, lëvizjet e brendshme dhe martesat.
- **Instituti i Shëndetit Publik** për numrin e aborteve, sëmundjet seksualisht të transmetueshme HIV/AIDS sipas viteve dhe gjinisë.
- **Anketa e Forcave të Punës**, për nivelin arsimor të popullsisë, shkallën e pjesëmarrjes në forcat e punës, popullsinë joaktive 15+, shkallën e punësimit, struktura e punësimit, të punësuar sipas sektorëve, shkallën e papunësisë.
- **Anketa Demografike e Shëndetit** për të dhëna në lidhje me përdorimin e duhanit dhe alkoolit, konsumimin e frutave dhe zarzavateve, indeksin e masës trupore, numrin e ushtrimeve aerobike, përqindjen e personave 15-49 vjeç që përdorin një llogari në një bankë dhe përqindje që kanë një telefon celular.
- **Rektoratet e Universiteteve Publike** për stafin Universitar dhe trupin mësimor sipas niveleve arsimore, përqindja e studentëve me aftësi të kufizuar sipas niveleve arsimore dhe gjinisë.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** për pagën mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë sipas gjinise, hendeku gjinor i pagave sipas aktivitetit ekonomik dhe grup profesioneve.
- **Instituti i Sigurimeve Shoqërore** për pensionet urbane dhe rurale, moshën mesatare të daljes në pension për pensionet e reja të pleqërisë, kontribuesit në skemën e sigurimit vullnetar.
- **Shërbimi Kombëtar i Punësimit** për numrin total të punëkërkuësve sipas gjinisë.
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** për numrin e familjeve që marrin ndihmë ekonomike sipas gjinisë së kryefamiljarit.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** për autorë sipas veprave penale dhe gjinisë, të dëmtuarit sipas veprave penale dhe gjinisë, normën e grave që raportojnë dhunë në familje, të dëmtuarit sipas gjinisë dhe veprave penale të trafikimit, dhunën në familje dhe krime seksuale, numrin e vasjeve dhe viktimat për shkak të marrëdhënieve familjare sipas gjinisë, lidhjen viktimë-autorë të veprës dhunë në familje, numrin e punonjësve në strukturat e policisë sipas gradave dhe gjinisë.
- **Prokuroria e Përgjithshme** për të pandehur sipas gjinisë.
- **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** për të burgosurit sipas gjinisë.
- **Kuvendi i Shqipërisë** për përbërjen e parlamentit që nga viti 1920, deputetët sipas partive politike dhe gjinisë, përbërjen e komisioneve parlamentare sipas gjinisë.
- **Ministria e Punëve të Jashtme** për pjesëmarrjen në misionet diplomatike sipas gjinisë.
- **Ministria e Mbrojtjes** për numrin e punonjësve në forcat e armatosura sipas gjinisë.
- **Shkolla e Magjistraturës** për pozicionet në shkollën e magjistraturës sipas gjinisë, përqindjen e studentëve fitues në shkollën e magjistraturës.
- **Këshilli i Lartë Gjyqësor** për pozicionet në sistemin e drejtësisë sipas gjinisë.
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** për të dhënat gjinore për kandidimin në

18.1. Burimi i të dhënave

	<p>zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore për Këshillin Bashkiak.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Departamenti i Administratës Publike</b> për pozicionet sipas nivelit të menaxhimit në institucionet e administratës publike.</li> <li>• <b>Regjistri i ndërmarrjeve</b> për ndërmarrjet aktive dhe të reja sipas gjinisë së pronarit/administratorit dhe aktivitetit ekonomik.</li> <li>• <b>Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve</b> për përfituesit e skemave mbeshetëse sipas gjinisë.</li> <li>• <b>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</b> për numrin e lejeve të drejtimit të lëshuara sipas gjinisë.</li> <li>• <b>Banka e Shqipërisë</b> për depozituesit dhe huamarrësit sipas gjinisë në Bankat Tregtare.</li> <li>• <b>Anketa e Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave</b> për përjetimet e dhunës ndaj grave dhe vajzave, nivelin arsimor të autorëve të dhunës në familje.</li> <li>• <b>Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës</b> për rrezikun për të qënë i varfër ose përjashtimi social sipas gjinisë, vetë perceptimin e gjendjes së përgjithshme shëndetësore për individët 16 vjeç e lart, përqindjen e individëve 16 vjeç e lart që kanë patur nevoja të paplotësuara për kujdes mjekësor dhe dentar.</li> <li>• <b>Anketa e Buxhetit të Familjes</b> për numrin e NjEF sipas tipologjis dhe gjinisë së kryefamiljarit, personat e vetëm dhe personat e vetëm me fëmijë sipas moshës dhe gjinisë së kryefamiljarit, njësitë ekonomike familjare sipas moshës dhe gjinisë së kryefamiljarit, shpenzimet mesatare mujore për konsum dhe struktura e shpenzimeve të konsumit sipas gjinisë së kryefamiljarit.</li> <li>• <b>Anketa mbi Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Familje dhe nga Individët (TIK)</b> për shpërndarjen e shpeshtësisë së përdorimit të TIK sipas gjinisë, blerjet online sipas grup-moshave dhe gjinisë.</li> <li>• <b>Avokati i Popullit</b> për ankesat për shkelje të së drejtave sipas gjinisë, rekomandime të trajtuara sipas gjinisë, personeli i Institutit të Avokatit të Popullit.</li> </ul>
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza vjetore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat grumbullohen me frekuencë vjetore, çdo fund muaji Shkurt për burimet administrative, të listuara në pikën 18.1 ku burimi primar i klasifikimit është gjinia. Lidhur me treguesit që sigurohen nga INSTAT nëpërmjet anketave dhe burimeve administrative, të dhënat sigurohen brenda muajit Prill të çdo viti.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	<p>Të dhënave të treguesve të pabarazisë gjinore ju janë bërë kontrolle logjike dhe matematikore. Ndër metodat e verifikimit të të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistenca me kalimin e kohës, korrigjimet aritmetike (nuk duhet të jenë shumë të larta), kontrollet përmbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha etj.</p> <p>Ndërsa për të dhënat nga anketimet, procedurat e redaktimit të të dhënave në përgjithësi i referohen redaktimit në nivel mikro:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kontrolli fizik i pyetësorit.</li> <li>2. Pështetimi i përshtatshme ri-llogaritjet për çdo njësi që ka raportuar të dhënat e saj.</li> <li>3. Vleftësimi i të dhënave bëhet gjithashtu duke krahasuar të dhënat e vlerave aktuale apo me ato të një viti paraardhës.</li> </ol>
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.

18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komentë	
Aneks	